



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN  
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerzitet Prizrena "UKSHIN HOTI"	
Pranuar më dt. 26.01.2018	
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-28/A

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren - Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

*Pataj*

Nr. protokollit 01-28/A Datë: 26/01/2018

Senati i Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren shpall:

## KONKURS

### PËR ANGAZHIMIN E PERSONELIT AKADEMIK NË BAZË TË NEVOJAVE TË NJËSIVE AKADEMIKE

*Angazhimi me honorar i personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti", Rregullores nr. 198/2015 për të ardhura personale dhe Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës nr. 03/L-212.*

#### a) Kushtet e përgjithshme për angazhim

1. Personeli i jashtëm akademik mund të angazhohet në UPZ për një periudhë të caktuar kohore, me qëllim të realizimit të veprimtarisë arsimore e shkencore mbi bazën e një konkursi publik për bashkëpunëtorë të jashtëm (me honorar). Angazhimi nuk nënkupton sipas këtij konkursi themelimin e marrëdhënies së rregullt të punës e as pagesë me automatizëm gjatë periudhës për të cilën angazhohet.

2. Gjatë përzgjedhjes së stafit për angazhim në mësimdhënie (ligjërata), Universiteti "Ukshin Hoti" do t'u japë përparësi kandidatëve që janë pjesë e universiteteve me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, pastaj kandidatëve të cilët edhe më parë kanë qenë të angazhuar në Universitetin "Ukshin Hoti" dhe që kanë treguar performancë të mirë.

3. Dekanati i njësisë akademike brenda afatit të konkursit duhet ta paraqesë listën në formë kërkesë me emrat e stafit që do të angazhohen në UPZ, që vijnë nga institucionet e akredituara të arsimit të lartë me të cilat Universiteti ka marrëveshje bashkëpunimi.

4. Stafi administrativ i Universitetit "Ukshin Hoti" nuk mund të angazhohet në procesin e mësimdhënies.

#### b) Fondi i orëve mbinormë (honorar) dhe kohëzgjatja e kontratës

1. Personeli akademik që nuk ka marrëdhënie të rregullt pune në Universitetin "Ukshin Hoti", i cili angazhohet nga jashtë (bashkëpunëtor i jashtëm), mund të mbajë deri në 6 orë ligjërata në javë, ndërsa asistenti deri në 8 orë ushtrime në javë. Nga kjo pikë bëjnë përjashtim ligjëruesit e angazhuar në Gjuhën turke dhe në Gjuhën boshnjake, të cilët mund të mbajnë deri në 8 orë ligjërata në javë.

2. Kandidatët të cilët do të përzgjidhen në kuadër të personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie dhe ushtrime, do të pajisen me kontrata pune me honorar (varësisht nga fondi i orëve që ka) për periudhën nga 15. 02. 2018 – 15. 06. 2018.

3. Kompensimi do të bëhet në përputhje me raportin e orëve të realizuara gjatë semestrit të caktuar, i cili vërtetohet nga njësia akademike përkatëse, por jo më shumë se fondi i orëve i përcaktuar sipas rregullores në fuqi për të ardhurat personale të personelit akademik të UPZ-së.

4. Personeli i angazhuar që ka thirrje akademike: Prof. i rregullt, Prof. i asociuar; Prof. asistent dhe Ligjërues, përveç orëve të ligjëratave të mbajtura, i kompensohen edhe orët e ushtrimeve në raport 2:1 ( 2 orë ushtrime = 1 orë ligjëratë) në kuadër të normës së paraparë.

5. Në kuadër të kontratës me honorar është përfshirë edhe mbajtja e provimeve dhe angazhimet e tjera, si: konsultimet me studentë dhe mbajtja provime në tri afate të rregullta dhe deri në dy afate të jashtëzakonshme (nëse e lejon Senati), prandaj pagesa sipas nenit 8 të Rregullores nr. 198/2015 nuk mund të realizohet në këto raste. Pas kalimit të kësaj periudhe, nëse i njëjti mësimdhënës (bartës i lëndës) nuk angazhohet në Universitet, dekani i njësise akademike duhet të veprojë zyrtarisht për pezullimin e llogarisë së tij në SEMS dhe sipas nevojës të formojë komision.

6. Të gjitha kontratat e përkohshme të angazhimit me honorar do të jenë të bazuara në dispozitat e Statutit të Universitetit “Ukshin Hoti”, rregullores në fuqi për të ardhura personale të personelit akademik të UPZ-së dhe në Ligjin e Punës së Republikës së Kosovës nr. 03/L-212 përkatësisht dispozitave të nenit 8; nenit 10 paragrafi 2, pika 2.2, paragrafit 4, 7 dhe 8; nenit 11 dhe nenit 14 të këtij ligji.

7. Një mësimdhënës mund të angazhohet për dy ose më shumë lëndë të së njëjtës fushë në njësitë akademike, duke mos e tejkaluar normën e plotë.

**c) Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:**

Kandidatët pjesëmarrës në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- Kërkesën dhe CV-në;
- Certifikatën e lindjes;
- Kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar nga organi kompetent (kandidatët që kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, duhet të sjellin edhe vendimin e nostrifikimit të diplomës përkatëse: bachelor, master/ magjistraturë, doktoraturë);
- Kandidatët të cilët aplikojnë për pozitën e asistentit ose lektorit, duhet të sjellin edhe certifikatën e notave të studimeve bachelor dhe master;
- Dëshmi për publikime shkencore e profesionale, si dhe informata të tjera specifike shtesë;
- Dëshmi për angazhime në UPZ (nëse kanë qenë të angazhuar më parë) ose në ndonjë institucion tjetër (të akredituar) të arsimit të lartë;
- Kandidatët që nuk kanë shtetësi të Republikës së Kosovës, duhet të sjellin dëshminë e lejeqëndrimit. Nëse nuk kanë qëndrim rezident në Republikën e Kosovës, të sjellin një deklaratë nën betim që nuk janë banorë rezidentë në Republikën e Kosovës.
- Dëshmia për njohjen e gjuhëve të huaja (qoftë e gjuhës angleze, qoftë e ndonjë gjuhe tjetër të huaj) u jep përparësi kandidatëve.

## I) FAKULTETI I EKONOMISË

1. Një mësimdhënës për lëndën: *Sociologji (Z)*;
2. Një mësimdhënës për lëndën: *Kërkimet në marketing (O)*;
3. Një mësimdhënës për lëndën: *Anglishtja afariste II (Z)*;
4. Një mësimdhënës për lëndën: *Kontabiliteti menaxherial (O)*;
5. Një mësimdhënës për lëndën: *Raportimi financiar II (O)*;
6. Një mësimdhënës për lëndën: *Ligji i kompanive*;
7. Një mësimdhënës për lëndët: *Gjuhë gjermane I (Z)* dhe *Gjuhë gjermane II (Z)*;
8. Një mësimdhënës për lëndën: *Gjuhë turke II (Z)*;
9. Një mësimdhënës për lëndën: *Gjuhë turke III (O)*;
10. Një mësimdhënës për lëndën: *Kontabiliteti menaxherial i avancuar (O)*;
11. Një mësimdhënës për lëndën: *Kontabiliteti publik (O)*;
12. Një mësimdhënës për lëndën: *Auditimi intern (Z)*;
13. Një mësimdhënës për lëndën: *Historia e civilizimit të Ballkanit (O)*;
14. Një mësimdhënës për lëndën: *Pasqyrë e trashëgimisë kulturore në Kosovë (O)*;
15. Një asistent për lëndën: *Statistikë (O)*;
16. Një asistent për lëndën: *Sociologji (Z)*;
17. Një asistent për lëndën: *Sistemi informativ në biznes (O)*;
18. Një asistent për lëndën: *Raportimi financiar II (O)*;
19. Një asistent për lëndën: *Financat ndërkombëtare (O)*;
20. Një asistent për lëndën: *Ligji i kompanive (O)*;
21. Një asistent për lëndën: *Anglishtja afariste II (Z)*;
22. Një asistent për lëndët: *Gjuhë gjermane I (Z)* dhe *Gjuhë gjermane II (Z)*;
23. Një asistent për lëndën: *Gjuhë turke II (Z)*;
24. Një asistent për lëndën: *Gjuhë turke III (O)*.

## II) FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

### a) Në gjuhën shqipe:

1. Dy mësimdhënës për lëndët: *Matematika diskrete (SD dhe TIT sem II (O), Msc. sem. II (Z)*;
2. Një mësimdhënës për lëndët: *Cloud Computing (TIT sem VI (O), Msc. sem. II (O)* dhe *Algoritmet e përzgjedhura (Msc. sem. II (O)*;
3. Një mësimdhënës për lëndët: *Autentifikim dhe Kriptografi (TIT sem. IV (O), Sistemet e shpërndara (SD sem. VI (O)*;
4. Një mësimdhënës për lëndën: *Language Technology (Msc. sem. II (Z)*;
5. Dy mësimdhënës për lëndët: *Anglisht për shkenca kompjuterike 2 (TIT dhe SD sem. II (Z)* dhe *Anglisht për shkenca kompjuterike 4 (TIT sem. IV (Z)*;
6. Një mësimdhënës për lëndën: *Konceptet e telekomunikimit mobil (TIT sem. VI (O)*;
7. Një mësimdhënës për lëndën: *Ndërveprimi njeri – kompjuter (TIT sem. IV (Z)*;
8. Pesë asistentë: *Për grup lëndësh.*

**b) Në gjuhën turke:**

1. Një mësimdhënës për lëndën: *Matematikë diskrete* (sem. II (O));
2. Një mësimdhënës për lëndët: *E- Biznesi, Metodat e hulumtimit* ( sem.IV dhe sem. VI (O));
3. Një mësimdhënës për lëndët: *Algoritme dhe strukturat e të dhënave, Teknologjia TCP/IP, Cloud Computing* (sem. II, sem. IV, sem. VI (O));
4. Një mësimdhënës për lëndët: *Sensorët dhe interfejesi, Mikrokontrollerët, Arkitektura e Sistemeve dhe Sistemet Operative* (sem. II, sem. IV, sem. VI (O));
5. Një mësimdhënës për lëndët: *Autentifikim dhe Kriptografi, Përmbajtja dinamike e ueb inxhinieringut, Konceptet e telekomunikimit mobil* ( sem. IV, sem. IV, sem. IV (O));
6. Një mësimdhënës për lëndët: *Anglisht për shkenca kompjuterike 2* (sem. II (Z) dhe *Anglisht për shkenca kompjuterike 4* (sem IV (Z));
7. Katër asistentë për grup lëndësh.

**c) Në gjuhën boshnjake:**

1. Një mësimdhënës për lëndët: *Matematika diskrete, Sensorët dhe interfejesi, Mikrokontrolleret* (sem. II, Sem. II, sem.IV (O));
2. Një mësimdhënës për lëndët: *Algoritme dhe strukturat e të dhënave, Autentifikim dhe Kriptografi, Cloud Computing* (sem. II, sem. IV, sem. VI (O));
3. Një mësimdhënës për lëndët: *Teknologjia TCP/IP, Ueb disajn, Përmbajtja dinamike e ueb inxhinieringut* (sem. IV, sem. IV, sem. VI (O));
4. Një mësimdhënës për lëndët: *Arkitektura e sistemeve dhe Sistemet operative, Hyrje në ueb teknologjitë dhe gjuhët, Konceptet e telekomunikimit mobil* (sem. II, sem IV, sem.VI (O));
5. Një mësimdhënës për lëndët: *Anglisht për shkenca kompjuterike 2* (sem. II (Z) dhe *Anglisht për shkenca kompjuterike 4* (sem IV (Z));
6. Një mësimdhënës për lëndët: *E- Biznesi, Metodat e hulumtimit* (sem. IV (Z), sem. VI (O));
7. Katër asistentë: Për grup lëndësh.

**III) FAKULTETI I JURIDIKUT**

1. Një mësimdhënës për lëndën: *Gjuhë angleze II* (O);
2. Një mësimdhënës për lëndën: *Gjuhë gjermane II*;
3. Një mësimdhënës për lëndën: *Teoria dhe Praktika Parlamentare* (O);
4. Një mësimdhënës për lëndën: *E Drejta Doganore* (O);
5. Një mësimdhënës për lëndën: *Fillet e së Drejtës ( Hyrje në filozofinë e së Drejtës dhe të Drejtës Publike)* (O);
6. Një mësimdhënës për lëndën: *E Drejta Administrative* (O);
7. Një mësimdhënës për lëndën: *E Drejta Penale II* (O);
8. Një mësimdhënës për lëndën: *Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare* (Z);
9. Një mësimdhënës për lëndën: *E Drejta e Procedurës Civile II* ( Jokontestimore) (O);
10. Një mësimdhënës për lëndën: *E Drejta Familjare dhe Trashëgimore* (O);

11. Një mësimdhënës për lëndën: *E Drejta Ndërkombëtare e Punës* (O);
12. Një mësimdhënës për lëndën: *Politikat dhe Administrata Publike* (O);
13. Një mësimdhënës për lëndën: *Arbitrazhi dhe teknikat tjera për zgjidhjen alternative të kontesteve* (O);
14. Një mësimdhënës për lëndën: *Teoria e Marrëdhënieve Ndërkombëtare* (O);
15. Një mësimdhënës për lëndën: *Institucionet Financiare Ndërkombëtare* (O);
16. Një asistent për lëndën: *Teoria dhe Praktika Parlamentare, Politikat dhe Administrata Publike* (O);
17. Një asistent për lëndën: *E Drejta Penale II* (O);
18. Një asistent për lëndën: *E Drejta e Procedurës Civile II* (Jokontestimore) (O);
19. Një asistent për lëndën: *E Drejta Familjare dhe Trashëgimore* (O);
20. Një asistent për lëndën: *E Drejta Romake (Bazat dhe e Drejta sendore Romake)* (O);
21. Një asistent për lëndën: *E Drejta Civile Pjesa e Posaçme ( E Drejta Sendore)* (O);
22. Një asistent për lëndën: *Penologji* (O);
23. Një asistent për lëndën: *E Drejta Procedurës Penale II* (O).

#### IV) FAKULTETI I EDUKIMIT

##### a) Në gjuhën shqipe:

1. Një mësimdhënës për lëndën: *Metodologji e arteve figurative* (O);
2. Një mësimdhënës për lëndën: *Metodologjia e edukimit fizik* (O);
3. Një mësimdhënës për lëndën: *Bazat e shkencave natyrore me metodologji I* (O);
4. Një mësimdhënës për lëndën: *Metodologjia e mësimin të matematikës I dhe Metodologjia e njohjes së koncepteve matematikore* (O);
5. Një mësimdhënës për lëndën: *Lojërat gjuhësore në të mësuarit e gjuhës shqipe dhe metodologjia e leximit letrar* (Z);
6. Një mësimdhënës për lëndët: *Edukimi mjedisor dhe Bazat e shkencave natyrore me metodologji II* (O);
7. Një mësimdhënës për lëndën: *Punë dore me modelim* (O);
8. Një Mësimdhënës për lëndë: *Psikologjike* (O-Z);
9. Dy asistentë për lëndën: *Matematikë II* (O);
10. Një asistent për lëndën: *Metodologji e arteve figurative dhe vizatim* (O);
11. Një asistent për lëndën: *Letërsi për fëmijë* (O);
12. Një asistent për lëndë nga: *Psikologjia* (O-Z);
13. Një asistent për lëndë nga *Pedagogjia* (O-Z).

##### b) Në gjuhën turke:

1. Dy mësimdhënës për lëndë *Pedagogjike* (O-Z);
2. Një mësimdhënës për lëndën: *Punë dore me modelim* (O);
3. Një mësimdhënës për lëndën: *Gjuhë angleze II* (Z);
4. Dy mësimdhënës për lëndë *Psikologjike* (O-Z);
5. Një mësimdhënës për lëndën: *Bazat e shkencave natyrore me metodologji* (O);
6. Një mësimdhënës për lëndën: *Edukim mjedisor* (O);
7. Një mësimdhënës për lëndën: *Artet figurative me metodologji* (O);
8. Një mësimdhënës për lëndën: *Bazat e shkencave shoqërore me metodologji* (O);

9. Një mësimdhënës për lëndën: *Histori kombëtare* (O);
10. Një mësimdhënës për lëndën: *TIK në Programin Fillor dhe Parafillor* (O);
11. Një mësimdhënës për lëndën: *Bazat e arsimit muzikor me metodologji* (O);
12. Një mësimdhënës për lëndën: *Metodologji e njohjes së koncepteve matematikore* (O).

**c) Në gjuhën boshnjake:**

1. Një mësimdhënës për lëndë nga *Pedagogjia* (O-Z);
2. Dy mësimdhënës për lëndën: *Gjuhë boshnjake* (O);
3. Një mësimdhënës për lëndën: *Gjuhë angleze II* (Z);
4. Dy mësimdhënës për lëndë nga *Matematika* (O);
5. Një mësimdhënës për lëndë nga *Teknologjia informative*(O);
6. Një mësimdhënës për lëndë nga *Artet figurative* (O);
7. Një mësimdhënës për lëndë nga *Historia* (O);
8. Një mësimdhënës për lëndën: *Bazat e shkencave shoqërore me metodologji* (O);
9. Një mësimdhënës për lëndën: *Të Drejtat e fëmijës dhe etika profesionale e mësimdhënësit* (Z);
10. Një mësimdhënës për lëndën: *Punë dore me modelim* (Z).

**V) FAKULTETI I FILOLOGJISË**

**a) Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe:**

1. Një mësimdhënës për lëndët: *Gjuhë angleze II dhe IV* (O);
2. Një asistent për lëndët: *Gjuhësi ballkanike* (O), *Gjuhësi e përgjithshme* (O), *Morfologji historike* (Z), *Filozofi e gjuhës dhe qytetërim latin* (O);
3. Një asistent për lëndët: *Letërsi e vjetër* (O), *Letërsi krahasimtare* (O), *Letërsi e sotme shqipe, Letërsi antike* (Z);
4. Një asistent për lëndët: *Teori e letërsisë* (O), *Romantizëm* (O), *Shkrim kreativ* (Z), *Publicistikë shqiptare* (Z);
5. Një asistent për lëndët: *Gjuhë angleze II dhe IV* (O);
6. Një asistent për lëndët: *Psikologji* (O), *Sociologji e kulturës* (Z).

**b) Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze:**

1. Një mësimdhënës për lëndën: *Letërsi viktoriane* (O);
2. Një mësimdhënës për lëndët: *Letërsi Moderne amerikane* (Z), *Shoqëri amerikane* (O), *Poezi moderne angleze* (Z);
3. Një mësimdhënës për lëndët: *TEFL, Leximi dhe shkrimi* (O), *Përkthim anglisht shqip* (Z);
4. Një mësimdhënës për lëndët: *TEFL, Nxënësit e rinj* (O), *Vlerësimi dhe testet* (O), *Menaxhmenti në klasë* (O);
5. Një mësimdhënës për lëndën: *Gjuhë gjermane II* (O);
6. Një asistent për lëndët: *Letërsi viktoriane* (O), *Letërsi moderne amerikane* (Z), *Poezi moderne angleze* (Z);
7. Një asistent për lëndët: *TEFL Leximi dhe shkrimi* (O), *TEFL Nxënësit e rinj* (O), *Vlerësimi dhe testet* (O), *Menaxhmenti në klasë* (O);

8. Një asistent për lëndët: *Fonetikë dhe Fonologji* (O), *Anglishte për qëllime akademike* (O), *Morfologji* (O);
9. Një asistent për lëndën: *Shkrim Akademik* (O);
10. Një asistent për lëndën: *Gjuhë shqipe II* (O).

**c) Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane:**

1. Një mësimdhënës për lëndët: *Letërsi gjermane I dhe III* (O), *Seminar në shkencën e letërsisë* (Z);
2. Një mësimdhënës për lëndët: *Sintaksë e gjuhës gjermane* (O), *Hyrje në didaktikën e gjuhëve të huaja* (Z);
3. Një mësimdhënës për lëndët: *Gjuhë angleze I dhe III* (O);
4. Një mësimdhënës për lëndët: *Civilizimi dhe kultura gjermane II* (O), *Komunikimi ndërkulturor* (O);
5. Tre asistentë për lëndët: *Praktikë gjuhe II, IV, VI* (O) dhe *Gjuhë e sotme gjermane* (O);
6. Një asistent për lëndën: *Letërsi e gjuhës gjermane* (O).

**VI) FAKULTETI I SHKENCAVE TË JETËS DHE MJEDISIT**

1. Një mësimdhënës për lëndën: *Sistematikë dhe botanikë e pyjeve* (O);
2. Një mësimdhënës për lëndën: *Kimi e përgjithshme dhe organike 2* (O);
3. Një mësimdhënës për lëndën: *Pedologjia e pyjeve* (O);
4. Një mësimdhënës për lëndën: *Gjuhë angleze* (O);
5. Një mësimdhënës për lëndën: *Pedologjia e pyjeve dhe entomologjia e pyjeve* (O);
6. Një mësimdhënës për lëndën: *Agropylltari* (O);
7. Një mësimdhënës për lëndën: *Menaxhim i fermave* (O) dhe *Menaxhim i agrobiznesit* (O);
8. Një asistent për lëndën: *Pedologjia e pyjeve* (O);
9. Një asistent për lëndën: *Silvikultura 2* (O);
10. Një asistent për lëndën: *Agropylltari* (O).

Dokumentacioni dorëzohet në kopje fizike në fakultetet përkatëse nga ora 09:00 deri në orën 15:00, në objektet e Universitetit “Ukshin Hoti”, adresa: “Rruga e Shkronjave”, nr. 1, 20000 Prizren. Të drejtë aplikimi, pa kurrfarë diskriminimi, kanë të gjithë kandidatët e interesuar, të cilët i plotësojnë kriteret për aplikim. Nuk mund të aplikojnë kandidatët që kanë arritur moshën e pensionit sipas dispozitave ligjore në fuqi ose që e arrijnë këtë moshë para datës 15. 02. 2018. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në faqen zyrtare respektivisht deri më 09.02.2018. Publikimi i listave bëhet në faqen zyrtare të Universitetit “Ukshin Hoti” ([www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com)) më 13.02.2018.

**Afati i ankesave është 8 ditë**, duke filluar nga data 13.02.2018 – 19.02.2018 (deri në orën 15:00). Ankesat bëhen në njësitë akademike përkatëse dhe i drejtohen Komisionit të formuar nga Këshilli i Fakultetit. Anëtarët e Komisionit për vlerësim të kandidatëve nuk mund të jenë edhe anëtarë të Komisionit të ankesave.

Komisioni obligohet që brenda 7 ditësh të shqyrtojë dhe të kthejë përgjigje lidhur me ankesën.

**Vërejtje:** Lëndët janë të specifikuara, si: **obligative (O)** dhe **zgjedhore (Z)**.

Të gjitha ato lëndë zgjedhore, për të cilat nuk plotësohet numri minimal i studentëve për formimin e grupeve sipas rregullores, do të anulohen, prandaj Universiteti “Ukshin Hoti” paraprakisht u bënë të ditur kandidatëve se përzgjedhja e tyre për lëndë zgjedhore nuk nënkupton domosdoshmërisht angazhimin e tyre për këtë semestër.

Njësitë akademike dalin me njoftime zyrtare rreth lëndëve zgjedhore.